

E DI TË MIRËN?
E DI TË KEQËN?
**E PO HAJDE PRA,
BEJMË MIRË E MOS BEJMË KEQ!**



Besim Rexhiqi

Mërgimtarët, jemi qenja njerëzore më e vuajtur e një kombi.
Edhe ne shqiptarët, kemi pas fatin e tillë dhe kemi vuajtur por në aspektin human nuk është vënë asnjëherë në pikëpyetje mbështetja dhe përkrahja familjare.

Me krijimin e Shoqates Humanitare Koretini, unë personalisht, përkrahjen nuk e vë këtë si detyrim për pjestarët e komunitetit që jetojnë ose kanë prejardhje nga Koretini.

Unë përkrahjen e shoqatës me një shumë simbolike vjetore, të llojit të anëtarësisë e shoh si dhurim, ku për burim e ka zemrën dhe përmes saj, çdo njeri duhet ta ndiej atë si burim që e ka shpirtin dhe i dedikohet shpirtit njerëzor.

Sadakaja apo ta quajmë dhurim për qellim të mirë, është vet ndjenja që duhet të krijohet te secili dhe njeherit në radhë të parë të jemi mirënjohës por edhe falenderues ndaj perëndisë që ne sot jemi mirë dhe jetojmë të lumtur me familjet tona.

Të mendojmë ndryshe!

Mos të marrim ditën e Kurban Bajramit si një ditë të vetme të shejnt për të dhuruar.

Secili nga ne që dëshiron të dhuroj. Atë shumë apo vlerë mund të derdhe në gjirrollogarin e shoqatës dhe ju garantoj se qellimi juaj shpirtor do të përmbushet 100%.

FALËNDERO PER ATE QE KE, MENDO SE MUND TË KISHE FATIN NDRYSHE!

Faleminderit njëmijë herë, gjithë atyre që kanë ndihmuar, ndihmojnë dhe do të ndihmojnë Shoqatën.

Watt, 13.11.2017